

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e katërt e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Fushë-Kosovës, e mbajtur me datën 25.05.2026, në ora 11:00h, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Vlonjat Hasani - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Filloreta Musaj, Rrahim Sogojeva, Laureat Gojnovci, Dardane Sogojeva Shala dhe Ali Ismaili.

Prezentë nga Ekzekutivi i Komunës: Taulant Kelmendi - Drejtor për Planifikim Urban, Izja Mjeku - Drejtor për Shërbime Publike dhe Mjedis dhe Mirsad Qyqalla - Drejtor për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Të tjerë: Lindita Dervisholli Prebreza - Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore.

REND DITE

1. Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë Kosovës e datës 27.04.2026.
2. Propozim për shqyrtimin e lirit nga pagesa e taksës për legalizmin e objekteve individuale për banim për gratë dhe personat më nevojë të veçanta.
3. Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese.
4. Propozim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e iniciativës së përbashkët me Komunën e Obiliqit për organizimin dhe fuqizimin e kujdesit dytësor shëndetësorë
5. Shqyrtimi i dytë i Projekt - Rregullores për taksa komunale.
6. Shqyrtimi i dytë i Projekt - Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.
7. Shqyrtimi i dytë i Projekt - Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës.
8. Shqyrtimi i dytë i Projekt - Rregullores për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
9. Shqyrtimi i dytë i Projekt - Planit Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë Kosovës për vitet 2026 - 2028.
10. Shqyrtimi i parë i Projekt - Rregullores për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike.
11. Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029.

12. Propozim për shqyrtimin e Kërkesave të Shoqatave të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Clirimtare të Kosovës Nr. 01-104/02-0005477/26 dhe Nr. 01-104/02-0003204/26 për lejimin e mjeteve financiare.
13. Rishqyrtimi i vendimit Nr. 65, të datës 24.02.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë Kosovë.
14. Shqyrtimi i Kërkesës Nr. 02-070/05-0015252/26, të datës 25.05.2026, për ndihmë financiare Shoqatës së Kosovës për Kërkim Shpëtim.
15. Propozim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Planin Komunal për Gjithpërfshirje Sociale.
16. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje të nderuar të pranishëm anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, po e hapim zyrtarisht mbledhjen, po filloj me leximin e pikave të rendit të ditës, ju njoftoj se pika e katërt për arsye procedurale tërhiqet nga shqyrtimi, i kemi edhe dy pika shtesë: Shqyrtimin e Kërkesës Nr. 020-7005-0015252/26 të datës 25.05.2026, për ndihmë financiare të Shoqatës së Kosovës për Kërkim-Shpëtim dhe Propozimi për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Planin Komunal për Gjithpërfshirje Sociale. Hap diskutimin

Rrahim Sogojeva: Përshëndetje kolegë, ne pajtohemi me rendin e ditës dhe dy pikat shtesë të propozuara nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për shqyrtim në mbledhjen e sotme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Laureat Gojnovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, të nderuar drejtor, në parim ne nuk jemi dakort për shqyrtim të pikave shtesë, nëse ato nuk janë të natyrës urgjente, ju si Grup Parlamentarë i Lëvizjes Vetëvendosje në të kaluarën, nuk i keni votuar asnjëherë pikat shtesë. Sa i përket 'Kërkesës së Shoqatës së Kosovës për Kërkim - Shpëtim', para dy ditëve kandidati për deputet në Kuvendin e Kosovës z. Naim Bardiqi së bashku me Kryetarin e Komunës z. Valon Prebreza e kanë vizituar këtë shoqatë, ne jemi që kjo kërkesë të mos trajtohet në kohën e fushatës zgjedhore që fillon të enjten.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, sa i përket pikave shtesë të rendit të ditës, është bërë një praktikë jo e mirë që çdo mbledhje të kemi pika shtesë, këto pika nuk janë urgjente dhe ne nuk i përkrahim.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Pika e tretë lidhur me Spitalin Hospice, thuhet se duhet të harmonizohet me dokumentat e planifikimit hapësinorë, ne kemi shpresuar se kjo mënyrë e punës do të ndalet, sepse ju e keni anuluar vendimin për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal nga mbledhja e shtatorit 2025, të cilin e ka kontestuar si të kundërligjshëm edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të mos e vendosni këtë komitet në lajthitje, njëjtë kontestohet edhe pika e katërmëdhjetë për caktimin e lokacionit për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Fushë-Kosovë, po veproni njëjtë, në atë vend është kundërshtuar nga Ministria për të njëjtat arsye edhe ndërtimi i Xhamisë në Fushë-Kosovë, nuk po reflektoni, tani rregulloret i keni vendosur për miratim përfundimtarë, pa mbajtur asnjë takim shtesë me Grupin

Punues, është mirë që janë mbajtur diskutimet publike, është e mirë edhe thirrja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për pjesëmarrje në diskutim publik, unë kam qenë në Grupin Punues për subvencione, këto rregullore janë të nevojshme, por jo në këtë mënyrë, tani jemi në mbledhjen e katër të Komitetit për Politikë dhe Financa, ju prapë po propozoni pika shtesë, që nuk janë urgjente, në kundërshtim me procedurat e vendosjes së tyre në shqyrtim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kërkesa e Shoqatës së Kosovës për kërkim-shpëtim është humane, ata në kohën e vërshimeve në muajin janar 2026, na kanë ndihmuar dhe duhet të përkrahet nga të gjithë. Tani e qesim në votim 'Propozimi për mbështetja financiare për Shoqatën për Kërkim-Shpëtim'.

U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, përdori votën e dyfishtë dhe konstatoi që kjo pikë aprovohet dhe hyn për shqyrtim në rendin e ditës.

Tani e qesim në votim 'Propozimin për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Planin Komunal për Gjithëpërfshirjen Sociale'.

U votua me: katër vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj që hyn për shqyrtim në rendin e ditës edhe kjo pike me shumicë të votave.

Tani e qesim në votim tërheqjen e pikës së katërt nga shqyrtimi në mbledhjen e sotme.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me votim unanim votojnë për tërheqjen nga shqyrtimi të pikës së katërt të rendit të ditës.

Tani e qesim në votim për shqyrtim rendin e ditës me votimet e cekura më lartë.

U votua me: tre vota 'për', tre vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përdori votën e dyfishtë dhe konstatoj që aprovohet rendi i ditës me tërheqjen e pikës së katërt nga shqyrtimi dhe aprovimin e dy pikave shtesë për shqyrtim.

Pika e parë (1) - Aprovimi i Ekstraktit të Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e datës 27.04.2026.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi për shqyrtim për vërejtjet apo sugjerimet tuaja 'Ekstraktin e Procesverbalit të mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Fushë-Kosovës e mbajtur me datën 27.04.2026'. Hap diskutimin.

Rrahim Sogojeva: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim për aprovimin 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me datën 27.04.2026'.

Laureat Gojnovci: Faleminderit Kryesues i Kuvendit të Komunës, janë dy arsye pse nuk e votojmë këtë ekstrakt të procesverbalit. E para, sepse po shkelet Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës.

Dardane Sogojeva Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Mendoj që është shkelur Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës, nuk bëhet audio-incizimit, prapë mbledhja shkruhet me lapsë, andaj jemi kundërshtim.

Ali Ismaili: Unë kam vërejtje për këtë ekstrakt të procesverbalit, shumë pjesë më keni nxjerrë nga tema, shumë pjesë e keni zbuluar e shumë pjesë nuk jam përshkruar fare. Kërkoj të merret parasysh vërejtja ime te pjesa e diskutimit për bartjen e buxhetit të pashpenzuar dhe informative financiare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani po e qesim në votim për aprovim 'Ekstraktin e Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 27.04.2026', me përmirësimet nga të gjitha vërejtjet e mia.

U votua me: tre vota 'për', një votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej pesë anëtarë pjesëmarrës në votim.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoj se aprovohet 'Ekstrakti i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 27.04.2026', me përmirësimin e tij.

Pika e dytë (2) - Propozim për shqyrtimin e lirit nga pagesa e taksës për legalizimin e objekteve individuale për banim për gratë dhe personat më nevoja të veçanta.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Materialin e keni para vetës, besoj e keni lexuar, tani po e hapi diskutimin.

Rrahim Sogojeva: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e përkrahim këtë propozim dhe kërkojmë që të procedohet për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Laureat Gojnovci: Ky propozim është i mire si ide, por nuk e ka një vlerësim sa është ndikimi i tij, sa do të jetë ndikimi, sa objekte do të legalizohen nga ky proces, sa ndikon në të hyrat komunale, andaj ne do të abstenojmë.

Lindita Dërvisholli Prebreza: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kjo është një masë afirmative, që ndihmon në legalizimin e pronave, andaj ne mendojmë se duhet të përkrahet.

Laureat Gojnovci: Nëse sqarohet sa prona mund të legalizohen nga ky proces, ne do ta votojmë.

Ali Ismaili: Këto legalizime duhet të bëhen për periudhën e ndërtimeve nga viti 2004-2018, njerëzit do të aplikojnë, këtu hyn ndërtimet pa leje, të cilat mund të legalizohen pa taksa nga gratë dhe personat me nevoja të veçanta, na tregoni sa mund të jetë vlera e tyre dy million euro, dhjetë million euro, kemi të bëjmë gati me një periudhë njëzet vjeçare, andaj duhet ta kemi një vlerësim nga Drejtoria e Planifikimit Urban, ta kemi një elaborim sa prona mund të legalizohen në këtë proces, me lirin nga taksat komunale për legalizim.

Drejtori për Planifikim Urban: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu nuk legalizohen objektet pa dokumente, Shifra sa është numri nuk mund të jepet, a do të jenë pesë qind shtëpi/njësi të banimit, këtë nuk mund ta dijmë.

Dardane Sogojeva Shala: Ne duhet ta dijmë numrin e këtyre njësive që mund të legalizohen.

Ali Ismaili: Propozimi është që të legalizohen objektet e kategorisë së parë të ndertimeve pa leje deri në vitin 2018 në Fushë-Kosovë, por edhe në fshatra sikur janë Bardh i Madh, ne duhet ta kemi një vlerësim për këto prona.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo punë nuk mund të bëhet me analizë të thjeshtë, duke thënë janë kaq njësi të banimit, është process që mund të vlerësohet vetëm pas disa muajve të zbatimit, nuk mund të jetë numër i madh, sepse ka prona edhe të trashëguara, që nuk zgjidhen lehtë. Pas sqarimeve e qesim në votim 'Propozimit për shqyrtimin e lirit nga pagesa e taksës për legalizimin e objekteve individuale për banim për gratë dhe personat më nevojë të veçanta'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe tre abstenime, gjithsej gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e aprovuan për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për shqyrtimin e lirit nga pagesa e taksës për legalizimin e objekteve individuale për banim për gratë dhe personat më nevojë të veçanta', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për shqyrtimin e lirit nga pagesa e taksës për legalizimin e objekteve individuale për banim për gratë dhe personat më nevojë të veçanta.

Pika e tretë (3) - Propozim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Po e hapim diskutimin për pikën e katërt, Lëvizja Vetëvendosje qëndrimi juaj?

Rrahim Sogojeva: Caktimi i lokacionit për ndërtimin e 'Spitalit Hospice', është një projekt shumë me rëndësi humane, është për pacientët të cilët kanë trajtim mjekësor për sëmundje, që janë të pashërueshme, e përkrahim për aprovim dhe procedim për shqyrtim në Kuvendin e Komunës.

Laureat Gojnovci: Në parim ne e përkrahim, një spital i tillë është i mirë për njerëzit që kanë dhimbje në fund të jetës së tyre, kjo punë duhet të vendoset në Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Kosovës, sepse atje e kemi një zonë pyjore me destinim, nuk mund ta ndryshoni me vendime, por me plane strategjike, jo me zotime.

Drejtori për Planifikim Urban: Lokacioni në lagjen e Bresjes për Qendër shëndetësore nuk po pranohet, për arsye se është udhëkryq, që ndërlidhet edhe me lagjen 028, ne e kemi dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë 'Projekt-Planin Zhvillimor Komunal', ku parashihet edhe spitali në fjalë, që do të ndërtohet në nivel vendi, është në interesin e gjithë shoqërisë, këtu prona është e shtetit, nuk duhet të bëjmë politikë.

Laureat Gojnovci: Këtë propozim e kthen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, sepse zyrtarët e Ministrisë atje nuk punojnë me vlerësime, por me ligj dhe dokumente, sikur kanë punuar edhe në të kaluarën, për këtë arsye ua kanë kthyer edhe lokacionin për Qendrën shëndetësore në zonën e Bresjes, sepse nuk është në Hartën Zonale të Komunës, këtu nuk kemi të bëjmë me Ministrinë e Shëndetësisë, por me lokacione, plane dhe harta merret vetëm Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, andaj nuk mund të votojmë në kundërshtim me procedurat.

Dardane Sogojeva Shala: Materiali nuk është i plotë, mungon fleta poseduese, meqë nuk është në Planin Zhvillimor Komunal, unë sot jam kundër.

Ali Ismaili: Spitali Hospice duhet të jetë në dokumentet e planifikimit si zotim, ne nuk guxojmë të veprojmë kështu, duhet të veprojmë në mënyrë institucionale, meqë Planin Zhvillimor Komunal e kemi dërguar në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, veprimet që po i ndërmerri ju nuk shkojnë në këtë mënyrë, e keni vendosur me vendim ndërtimin me koeficientë 1.5, po nguteni dhe po veproni në kundërshtim me ligjin, tani Ish/Kryetari i Komunës z. Burim Berisha ka lëshuar leje me 0.8, sepse ka ndodhur një gabim në Hartën Digjitale në sistemin GIS, janë dhënë kompenzime me bonuse për ndërtimin e shkollave dhe çerdheve, njëjtë kam kërkuar që të veprohet edhe për objektin e Xhamisë në raport me Bashkësinë Islame, por nuk ka patur mirëkuptim, mendimi im është se nuk duhet t'i paraprijmë proceseve në këtë mënyrë, duhet ta presim vlerësimin për Planin Zhvillimor Komunal.

Drejtori për Planifikim Urban: Kjo punë ndërlidhet vetëm me ZK3, me zonën komerciale, për arsye të gabimit në hartën Digjitale, për të ndihmuar bizneset e Hib-Petrolit, Kosmonte Foods dhe të tjerave që kanë qasje në ZK3.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Drejtori e dha shumë mirë sqarimin, pas të cilit e qesim në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese'.

U votua me: tre vota 'për', dy vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej pesë pjesëmarrës në votim nga gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me shumicë të votave e aprovuan për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit Hospice dhe harmonizimin me dokumentet planifikuese'.

Pika e katërt (4) - Propozim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e iniciativës së përbashkëtë me Komunën e Obiliqit për organizimin dhe fuqizimin e kujdesit dytësor shëndetësorë - tërhiqet nga shqyrtimi në mbledhjen e sotme.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për taksa komunale.

Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike.

Pika e shtatë (7) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës.

Pika e tetë (8) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani nëse jeni dakort po e bashkojmë diskutimin për katër rregulloret komunale nga pika e katërt deri në pikën e shtatë.

Drejtori për Planifikim Urban: Ju duhet ta dini se për hapësira publike, ne si Drejtori e Planifikimit Urban e japim një pëlqim.

Rrahim Sogojeva: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentarë të Lëvizjes Vetëvendosje, ne i përkrahim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës për shqyrtimin e dytë.

Laureat Gojnovci: Kjo praktikë e ndjekur nga Ekzekutivi i Komunës për hartimin e këtyre katër 'Projekt-Rregulloreve Komunale', nuk është në rregull, të punohet vetëm një ditë në 'Resort Holiday' në Sllatinë të Madhe, pastaj të vazhdohet në Shqipëri vetëm nga Ekzekutivi i Komunës, të mos merren parasysh komentet e kolegëve tonë nga Kuvendi i Komunës, të mos thirret takime tjera të Grupit Punues, të anashkoalohet në këtë mënyrë pjesa e Kuvendit të Komunës, ne sot do të abstenojmë. Mungojnë kriteret për ndarjen e subvencioneve, mungojnë sqarimet për hapësirat publike, pastaj vlerësimet për vendosjen e taksave komunale për biznese që e zhvillojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e komunës, këto rregullore kanë nevojë të plotësohen ende dhe të analizohen mirë para aprovimit, diskutimi publik është mbajtur të merkuren, ndërsa projekt-rregulloret neve na janë dërguar të martën, verzioni i pa ndryshuar. Modeli për 'Rregulloren e hapësirave publike', është marrë nga Mitrovica e Veriut, te subvencionet nuk është punuar për bazë të modelit që e kemi punuar së bashku me anëtarin e Kuvendit të Komunës në mandatin e kaluar z. Durim Hajra, që ka qenë vetë Kryesues i Grupit Punues, që ka qenë një rregullore e analizuar mirë.

Ali Ismaili: Janë shpenzuar mbi dhjetë mijë euro dhe Rregulloret nuk janë përfunduar në vitin 2023, kjo punë nuk është në rregull, këto rregullore janë shumë të nevojshme, për funksionimin më të mirë të komunës. Unë kam qenë në Grupin Punues të 'Rregullores për ndarjen e subvencioneve, nuk kam mundur të marrë pjesë, kjo nuk ka rëndësi fare, por rregullores në fjalë, i mungojnë kriteret për ndarjen e subvencioneve, unë në shqyrtimin e parë i kam paraqitur vërejtjet e mia në mbledhjen e Kuvendit të Komunës dhe kam pritur që edhe puna jonë në vazhdim, do të ketë një standard të garantuar të trajtimit të neneve përkatëse, por kjo punë nuk ka ndodhur fare, nuk ka procesverbal për komentet e pranuar, apo të refuzuara, këto janë dilemat tona që kërkojnë një trajtim serioz dhe analizim profesional, para shqyrtimit dhe aprovimit të këtyre katër rregulloreve me rëndësi të madhe për komunën tonë.

Laureat Gojnovci: Në hartimin e akteve të përgjithshme, duhet ta kemi një punë të përbashkëtë dhe votim unanim, por kjo punë nuk është lejuar të bëhet në këtë rast, andaj ne do të abstenojmë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E para këtu nuk ka fare arrogancë të numrave, diskutimi publik ka qenë i hapur, nuk më keni përkrahur fare në thirrjen, që e kam bërë për pjesëmarrje të qytetarëve, për dy ditë nga ora 16:00h deri në orën 18:00h, për katër rregullore, nuk keni qenë prezentë fare për dëgjimin e kërkesave të qytetarëve, lidhur me këto katër projekt-rregullore, të cilat nuk janë përgatitur dhe aprovuar nga viti 2013, që e theksoi edhe Ish/Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, është shpenzuar buxheti i komunës, pa u finalizuar produkti, kjo punë tani me neve nuk mund të ndodh.

Drejtori për Planifikim Urban: Hapësirat publike kanë mangësi, ka nevojë për plotësime në disa nene të kësaj rregullore komunale, andaj unë nuk pajtohem që kështu të aprovohet.

Pas mospajtimeve dhe fjalimeve të ndërsjellta në mes të Drejtorit për Shërbime Publike dhe Mjedis, me anëtarin e Komitetit për Politikë dhe Financa z. Ali Ismaili, mbledhjen në shenjë mospajtimi me qasjen e tij, e lëshoi anëtari nga Lidhja Demokratike e Kosovës z. Laureat Gojnovci Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullores për taksa komunale'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e proceduan për shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregulloren për taksa komunale', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Shqyrtimit të dytë të Projekt-Rregullores për taksa komunale'.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e proceduan për shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregulloren për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve dhe hapësirave publike'.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e proceduan për shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Shqyrtimit të dytë të Projekt-Rregullores për ndarjen e subvencioneve në Komunën e Fushë-Kosovës'.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullores për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e proceduan për shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullore për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Shqyrtimit të dytë të Projekt-Rregullore për organizimin e bashkëpunimit të komunës me lagjet urbane dhe fshatrat në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.

Pika e nëntë (9) - Shqyrtimi i dytë i Projekt-Planit Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Diskutimi publik është mbajtur, ndryshime përmbajtësore nuk ka patur, andaj e hap diskutimin për qëndrimet tuaja. Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Planit Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028'. U votua unanimisht nga të pranishmit gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave e proceduan për shqyrtimin e dytë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Planit Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Shqyrtimit të dytë të Projekt-Planit Lokal të Veprimet për Barazi Gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2028'.

Pika e dhjetë (10) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullore për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në shqyrtimin e parë për kalim në procedurën e diskutimit publik, pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtimin e parë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullore për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike'.

U votua unanimisht nga të pranishmit gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave e proceduan për shqyrtimin e parë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Rregullore për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Shqyrtimit të parë të Projekt-Rregullore për lëshimin e lejes për instalimin e paneleve fotovoltaike'.

Pika e njëmbëdhjetë (11) - Shqyrtimi i parë i Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani e kemi në shqyrtimin e parë për kalim në procedurën e diskutimit publik, pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtimin e parë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.

U votua unanimisht nga të pranishmit gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave e proceduan për shqyrtimin e parë në Kuvendin e Komunës 'Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Shqyrtimit të parë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për avansimin e të drejtave të komuniteteve rom, ashkali në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2026-2029'.

Pika e dymbëdhjetë (12) - Propozim për shqyrtimin e Kërkesave të Shoqatave të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nr. 01-104/02-0005477/26 dhe Nr. 01-104/02-0003204/26 për lejimin e mjeteve financiare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve për kodet e financimit, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Kërkesat e Shoqatave të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nr. 01-104/02-0005477/26 dhe Nr. 01-104/02-0003204/26 për lejimin e mjeteve financiare'.

U votua unanimisht nga të pranishmit gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me unanimitet të votave e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Kërkesat e Shoqatave të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nr. 01-104/02-0005477/26 dhe Nr. 01-104/02-0003204/26 për lejimin e mjeteve financiare', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimt për shqyrtimin e Kërkesave të Shoqatave të Veteranëve dhe Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Nr. 01-104/02-0005477/26 dhe Nr. 01-104/02-0003204/26 për lejimin e mjeteve financiare, në kodet e subvencioneve të Zyrës së Kryetarit të Komunës, Shëndetësisë dhe Kulturës'.

Pika e trembëdhjetë (13) - Rishqyrtimi i vendimit Nr. 65, të datës 24.02.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve lidhur ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 65, të datës 24.02.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, me zotimin për përfshirjen në dokumentet e planifikimit hapësinorë.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimin për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 65, të datës 24.02.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, me zotimin për përfshirjen në dokumentet e planifikimit hapësinorë', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Rishqyrtimit të vendimit Nr. 65, të datës 24.02.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë'.

Pika e katërbëdhjetë (14) - Shqyrtimin e kërkesës Nr. 02-070/05-0015252/26, të datës 25.05.2026, për ndihmë financiare Shoqatës së Kosovës për Kërkim Shpëtim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve për kodet e financimit, e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Kërkesës Nr. 02-070/05-0015252/26, të datës 25.05.2026, për ndihmë financiare Shoqatës së Kosovës për Kërkim Shpëtim'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Kërkesës Nr. 02-070/05-0015252/26, të datës 25.05.2026, për ndihmë financiare Shoqatës së Kosovës për Kërkim Shpëtim', me këtë:

R e k o m a n d i m

Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Kërkesën Nr. 02-070/05-0015252/26, të datës 25.05.2026, për ndihmë financiare Shoqatës së Kosovës për Kërkim Shpëtim'.

Pika e pesëmbëdhjetë (15) - Propozim për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Planin Komunal për Gjithëpërfshirje Sociale.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve e qiti në votim për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Planin Komunal për Gjithëpërfshirje Sociale'.

U votua me: tre vota 'për', asnjë votë 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej katër anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me shumicë të votave e proceduan për shqyrtim në Kuvendin e Komunës 'Propozimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Planin Komunal për Gjithëpërfshirje Sociale', me këtë:

R e k o m a n d i m


Për procedim dhe shqyrtim në Kuvendin e Komunës të 'Propozimit për caktimin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Planin Komunal për Gjithëpërfshirje Sociale'.

Pika e gjashtëmbëdhjetë (16) - Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A keni dikush për të shtruar ndonjë çështje për diskutim. Nëse jo atëherë falënderit shumë, shihemi në mbledhjen e radhës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 13:40 minuta.

**Procesmbajtës
Hasan Gjyrevci**



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vllonjat Hasani

